



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.937/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi Kryesues, Zuhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Vahudin Ibrahimimi nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.937/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Vahudin Ibrahimimi nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë për rinumërim në vendvotimin 1501E/03R, 1501E/05R, 1501E/04R, 1510E/01R, 1520E/02D, 1510E/02D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Vahudin Ibrahimimi nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë në të cilën kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin 1501E/03R, 1501E/05R, 1501E/04R, 1510E/01R, 1520E/02D, 1510E/02D sepse nuk i ka votat e miqve, familjareve dhe shokëve cilët e kanë votuar në këto qendra të votimit, në secilën qendër të cekur ka mungesë votash.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Vahudin Ibrahimimi nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin 1501E/03R, 1501E/05R, 1501E/04R, 1510E/01R, 1520E/02D, 1510E/02D.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin

konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë thënie ne apel, gjë që paneli vlerëson se pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.937/2021 më datën 07.11.2021



**Kryesues i Panelit
Burim Ademi**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nënit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.